



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Procesverbal i takimit publik me qytetarë për kërkesat e
tyre dhe ecurinë e projekteve
në **Krushë e Madhe, Celinë, Nagac, Hoçë e Vogël,**
Brestoc

	REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No 814	Nr. i faq/Br str/No.pg 178	
Data/Datum/Date 16 / 6 / 23		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e takimit publik me qytetarë për kërkesat e tyre dhe ecurinë e projekteve, u publikua me datë: 18.5.2023 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në të dy gjuhët, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/05/NJOFTIM-TAKIMET-ME-QYTETAR-KRUSHE-MADHE-CELINENAGAC-HOCE-E-VOGEL-BRESTOC.pdf>, në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimet Publike në Komuna, kryetari i Komunës, Smajl Latifi organizon takime publike me qytetarë për kërkesat e tyre dhe ecurinë e projekteve në fshatra dhe vendbanime të komunës së Rahovecit.

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së takimeve publike, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendari i takimeve publike për në vendbanimet e komunës së Rahovecit në këtë vegëz: Kalendari për organizimin e takimeve publike me qytetarë për kërkesat e tyre dhe ecurinë e projekteve, u publikua me datë: 18.5.2023 në të dy gjuhët, në këtë link:

<https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/05/Kalendari-i-takimeve-me-qytetare.pdf>

Poashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar me kohë banorët e secilit vendbanim rreth mbajtjes së takimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilën ditë të takimit, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit në atë vendbanim.

Njoftimet përveç që janë publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber.

TAKIMI PUBLIK NË KRUSHË E MADHE, CELINË, NAGAC, HOÇË E VOGËL DHE BRESTOC

Më datë: **2.6.2023** mbahet takimi publik me qytetarët në fshatrat: Krushë e Madhe, Celinë, Nagac, Hoçë e Vogël, Brestoc. Të pranishëm kanë qenë Kryetari i Komunës së Rahovecit, nënkryetari, disa drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunal.

Takimi filloi në ora 19:10

Takimin e shpalli të hapur Fjolla Duraku, e cila njoftoi qytetarët lidhur me udhëzimin administrativ rreth takimeve publike në komuna.

Smajl Latifi, kryetar i komunes: Përshëndetje për të gjithë, ju falenderojë për pjesëmarrjen tuaj. Karakteri i takimit është ti dëgjojmë kërkesat dhe nevojat tuaja, pastaj do ju përgjigjemi veçmas për secilen prej tyre.

Hysni Gashi, Nagac: I nderuar kryetar dhe gjithë të pranishmit këtu në sallë. Para se ti paraqesim kërkesat tona, kërkojmë nga ju informata rreth investimeve në fshatin Nagac, për vitin e kaluar.

Berat Duraku, drejtor i Bujqësisë: Përshëndetje për të gjithë, në fshatin Nagac është bërë shpërndarja e pajisjeve bujqësore, e kam pas edhe një kërkesë për një rrugë fushore, Brenda muajit do të fillojnë punimet.

Përparim Krasniqi, drejtor i Sherbimeve Publike: Mirëmbërma gjithë të pranishmëve, vitin e kaluar në fshatin Nagac kanë përfunduar dy segmente të kanalizimit 350m, një rrugë lokale dhe këtë vit kanë përfunduar punimet e shkallëve tek shkolla.

Avni Morina, drejtor i Arsimit: Ju përshëndes të gjithëve, ju falenderoj për pjesëmarrjen, në lokalitetin tuaj ka përfunduar eficientia e energjisë në shkollë, furnizimi i bibliotekës me libra dhe oborri i shkollës.

Afrim Dina, drejtor Kulturës, Rinisë dhe Sportit: Unë desha të ju njoftoj që parku në Nagac do të filloj në korrik.

Nebih Elshani, Nagac: Përsëritet të nderuar, Nagaci ka bërë shumë kërkesa, asnjë rrugic dhe rrugë fushore nuk është ndërtuar, disa here kemi kërkuar pastrimin e lumit për shkak se gjindet afer shkollës dhe kundermon arom te keqe, jemi të pakënaqur me ndertimin e shkallëve, ne aty kemi kërkuar asphalt.

Smajl Latifi, kryetar i komunës: Disa punë të cilat kanë përfunduar në Nagac, në vendbanime të tjera nuk janë bërë, lumi i fshatit njëherë është pastruar, do të bëhet edhe këtë vit. Sa i përket rrugëve fushore po shpresojmë që operatori ekonomik ti kthehet punimeve sepse ka ngecje.

Sejfullah Sejfullahu, Krushë e Madhe (asambleist): I nderuar kryetar, drejtor të drejtorive, qytetarë e gjithë jut ë pranishem, unë kërkesat e Krushës Madhe i kam adresuar edhe në kuvendin komunal, po shpresoj që këtë vit të rriten investimet, ndër kërkesat të cilat janë me prioritet:

- Stadiumi sportiv,
- Shtëpinë muze Bajram Curri,
- Ansambli,
- Rrugë fushore,
- Mirëmbajtja e varrezave

Zijadin Veliu, Krushë e Madhe: Unë po e paraqes disa kërkesa: shenjëzimin e rrugëve, vijat e bardha të jenë më të theksuara, mirëmbajtja e varrezave dhe posten në Krushë të Madhe.

Muhamet Ramadani, përfaqësues i fshatit Celinë: I nderuar kryetar, ju falenderojmë për disa investime që kanë ndodhë në fshatin Celinë: rregullimi i varrezave, fusha sportive dhe kemi kërkesë për ndërtimin e rrugëve fushore sepse e kemi më të nevojshme.

Jeton Berisha, fshati Brestoc: Të nderuar të pranishem, ju përsëritet të gjithëve dhe shfrytëzojë rastin të falenderoj stafin komunal për punën dhe angazhimin.

Disa nga kërkesat e fshatit Brestoc janë:

- Trotuare,
- Ndriçimi publik,
- Ndërtimi i një pjese të rrugës në drejtim të Rahovecit,
- Rrugë fushore,
- Ambullanta në Brestoc është jasht funksionit
- Demtimi i maleve

Smajl Latifi, kryetar i komunes: Të gjitha kërkesat duhet ti paraqitni edhe zyrtarisht në objektet e komunës, te rrugët fushore kanë filluar operatorët ekonomik punimet, tek ambulanta ne kemi filluar me rritjen e kapacitetit në rritje të personelit shëndetësor. Pjesa më e madhe e Brestocit është e përfshirë me ndriçim publik dhe së shpejti në komunën tonë do të digjitalizohet ndriçimi publik.

LISTA E NËNSHKRIMEVE

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Oraševac / Municipality Raževac

Lista e nënskrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në takimin publik me qytetarë me bazuar në fshatrave: Krahë e Madhe, Çelind, Nagje, Hapë e Vepër, Borec

Nr.	Emri	Mbiemri	Vendi	Nr. Tel	Nënskrimi
1.	VALAUR	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
2.	DOVINOVE	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
3.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
4.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
5.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
6.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
7.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
8.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
9.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
10.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
11.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
12.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
13.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
14.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
15.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
16.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
17.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
18.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
19.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
20.	ALIBARI	QASHI	NAGAJE	044 725 122	

№ 26.2021

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Oraševac / Municipality Raževac

Lista e nënskrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në takimin publik me qytetarë me bazuar në fshatrave: Krahë e Madhe, Çelind, Nagje, Hapë e Vepër, Borec

Nr.	Emri	Mbiemri	Vendi	Nr. Tel	Nënskrimi
1.	Fatmir	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
2.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
3.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
4.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
5.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
6.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
7.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
8.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
9.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
10.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
11.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
12.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
13.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
14.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
15.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
16.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
17.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
18.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
19.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	
20.	Agasi	QASHI	NAGAJE	044 725 122	

FOTOGRAFI





Ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!

Takimi përfundoi në ora 20:30.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun



Rahovec, qershor 2023